



Azienda Ospedaliera Nazionale
SS. Antonio e Biagio e Cesare Arrigo
Alessandria



Karta evropiane e te drejtave te semureve

- 1. E drejta per masat parandaluese:** Çdo individ ka te drejte per sherbime te pershtatshme shendetesore, per te parandaluar semundjen.
- 2. E drejta e hyrjes:** Çdo individ ka te drejten e hyrjes ne sherbimet shendetesore sa here qe e kerkon gjendja e tij shendetesore. Sherbimet shendetesore duhet te sigurojne hyrje te barabarte per te gjitha pa diskriminim bazuar tek burimet financiare, nga vendqendrimi, nga lloji i semundjes, apo nga momenti i perdorimit te sherbimit.
- 3. E drejta per informacion:** Çdo individ ka te drejte te informohet per gjithshka qe lidhet me gjendjen e tij shendetesore, per sherbimet shendetesore e menytrat e perdorimit, por edhe per disponibilitetin e te gjitha informacioneve te nxjerra nga kerkimet shkencore e inovacionet teknologjike.
- 4. E drejta per miratim:** Çdo individ ka te drejte te informohet mbi gjithshka qe lidhet me shendetin ne menyre qe te jete ne gjendje te marre pjese aktivisht ne vendimet qe lidhen me shendetin e tij. Keto informacione jane nje parakusht per çdo lloj procedure e trajtimi shendetesor, duke perfshire edhe pjesemarrjen ne eksperimente.
- 5. E drejta e zgjedhjes se lire:** Çdo individ ka te drejte te zgjedhe lirisht, ndermjet procedurave te ndryshme dhe ofruesve te sherbimit shendetesor, duke u bazuar tek informacionet e pershtatshme.
- 6. E drejta per ruajten e fsheftesise se informacioneve private (privacy) dhe e drejta e konfidencialitetit.** Çdo individ ka te drejten e konfidencialitetit te informacioneve me karakter personal, duke perfshire edhe ato qe lidhen me shendetin e tij, per procedurat e mundshme diagnostike e terapeutike si edhe te drejten e mbrojtjes se informacioneve private gjate zhvillimit te analizave diagnostikuese, vizitave te specializuara dhe trajtimeve mjekesore-kirurgjike ne pergjithesi.



- 7. E drejta per respektimin e kohes se pacienteve:** Çdo individ ka te drejte te marre trajtimin e duhur shendetesor per nje kohe te shkurter e te paracaktuar. Kjo e drejte mund te aplikohet ne çdo faze te trajtimit.
- 8. E drejta per respektimin cilesor te standarteve :** Çdo individ ka te drejten e hyrjes ne sherbimet shendetesore te cilesi se larte ne baze te percaktimit e respektimit te standarteve te sakta.
- 9. E drejta e sigurise:** Çdo individ ka te drejte te mos pesoje deme nga funksionimi i dobet i sherbimeve shendetesore apo nga gabimet mjekesore dhe ka te drejten e hyrjes ne sherbimet shendetesore dhe ne trajtimet qe permbushin standartet e larta te sigurise.
- 10. E drejta per inovacion:** Çdo individ ka te drejten e hyrjes ne procedurat e reja, duke perfshire edhe procedurat diagnostikuese, ne perputhje me standartet nderkombetare, e te pandevarur nga mundesite ekonomike apo financiare.
- 11. E drejta per te shmangur vuajtjet e dhimbjet e panevojshme:** Çdo individ ka te drejte te shmange vuajtjen aq sa te jete e mundur, ne çdo faze te semundjes se tij.
- 12. E drejta per nje trajtim te personalizuar:** Çdo individ ka te drejte per programe diagnostikuese ose terapeutike sa me te pershtatshme me nevojat personale.
- 13. E drejta per ankese:** Çdo individ ka te drejten e ankeses sa here qe peson nje dem dhe te drejten per te marre pergjigje.
- 14. E drejta per kompensim:** Çdo individ ka te drejten e nje kompensimi te pershtatshem, ne nje kohe te arsyeshme e te shkurter, sa here qe ka pesuar nje dem fizik, moral ose psikologjik te shkaktuar nga sherbimet shendetesore.